

VENDIM
Nr. 542, datë 9.8.2006

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË INSTITUTIT TË
STATISTIKAVE, TË DISA MJEDISEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË
SË KËTIJ INSTITUCIONI**

(Ndryshuar me VKM nr. 778, datë 22.11.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te Instituti i Statistikave, të zyrave të katit të dytë dhe të tretë, në ndërtesën 5-katëshe, të ish-Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, sipas planimetrisë “Aneks 1 dhe 2”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në dispozicion të Këshillit të Ministrave, për fond zyrash, të mjediseve me sipërfaqe 1080 m² që janë aktualisht në administrim të Institutit të Statistikave, në ndërtesën 3-katëshe të Ordinitorit Qendror, sipas planimetrisë “Aneksi 3”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


3. *Shfuqizuar.*

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë, Instituti i Statistikave dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1




Aneksi 2





- 10- ZYRA E KENDSHINIMI NE JASHTE 3 PERSONA
- 11- ZYRA E KENDSHITES 3 PERSONA
- 12- ZYRA E BLUESISE 5 PERSONA
- 13- ZYRA E NIVELIT TE JETES 2
- 14- ZYRA E INDEKST TE CHIVEVE 3
- 15- ZYRA E TREGTISE NE JASHTE 2
- 16- ZYRA E NDERMARJEVE 3
- 17- ZYRA E SEKTORIT TE NDERMARJEVE



- GRUP TRETJE
16- FINANCA 5 PERSONA
17- ADMINISTRATA 4, PERSONA
18- OPERATORET 10 PERSONA
19- ZYRA E PINES DHE E PAGAVE
20- ZYRA E TIRANES 5 PERSONA
21- SALLA E Mbledjeve
22- N-ye hidroantiera
23-SELF-SERVICE
24-KOORDINATORET

OBJEKT	EKONSTRUKSION: TRAVE	
PLAN: ORGANIZACIJA	ASX	1:502C 40118 P2
SM: 1:100	AKK. R.TOSKA	40118 P2

